

UDHËZIM
Nr. 7415, datë 13.9.2016

**PËR NGRITJEN E KOMISIONIT PËR SHQYRTIMIN E PËRPUTHSHMËRISË ME
POLITIKAT, STRATEGJITË DHE LEGJSLACIONIN SEKTORIAL NË MINISTRINË E
ZHVILLIMIT EKONOMIK, TURIZMIT, TREGTISË DHE SIPËRMARRJES, SI DHE
KRITERET TEKNIKE TË VEÇANTA, PËR LEJET QË MIRATOHEN NË KËSHILLIN
KOMBËTAR TË TERRITORIT OSE ÇËSHTJET QË LIDHEN ME PLANIFIKIMIN
DHE ZHVILLIMIN
E TERRITORIT**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, ligjit nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 671, datë 29.7.2015, “Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit”, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 835, datë 18.9.2013, “Për përcaktimin e fushës së përgje-gjesisë shtetërore të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes”, të ndryshuar dhe udhëzimit të Kryeministrit nr. 143, datë 3.11.2015, “Për ngritjen dhe funksionimin e strukturave përgjegjëse, për bashkërendimin e punës me Agjencinë e Zhvillimit të Territorit,

UDHËZOJ:

1. Ngritjen e Komisionit Vlerësues të Projek-teve dhe kërkesave për leje, si dhe çështjeve të territorit, të cilat kanë lidhje me fushën e përgjegjësisë, politikat dhe strategjitë sektoriale të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit dhe Sipërmarrjes (MZHE'TTS), për:

- lejet që miratohen në Këshillin Kombëtar të Territorit (KKT);
- lejet që miratohen nga pushteti vendor;
- çështjet që lidhen me planifikimin dhe zhvillimin e territorit.

2. “Komisioni vlerësues i lejeve dhe çështjeve të territorit”, më poshtë i quajtur “Komisioni”, kryesohet nga sekretari i përgjithshëm dhe ka në përbërje të tij, një nënkryetar dhe 5 (pesë) anëtarë, të cilët emërohen dhe shkarkohen me urdhër të ministrit.

3. Komisioni mblidhet me kërkesë të kryetarit, ose nënkryetarit, sa herë që kërkohet shqyrtimi dhe vlerësimi i projekteve, kërkesave për leje, çështje që lidhen me zhvillimin apo planifikimin e territorit, sipas fushës së veprimtarisë së MZHE'TTS-së, si dhe për raste specifike, sipas legjislacionit në fuqi.

4. Mbledhja e Komisionit zhvillohet vetëm në rast se janë të pranishëm jo më pak se gjysma e anëtarëve të Komisionit. Përgjithshëm, në pamundësi të pranisë së shumicës së anëtarëve, si më sipër, mbledhja mund të kryhet me praninë e jo më pak se 3 anëtarëve të Komisionit së bashku me kryetarin.

5. Komisioni gjatë mbledhjeve asistohet nga Sekretariati i Komisionit, i cili përbëhet nga 3 anëtarë, që emërohen dhe shkarkohen me urdhër të ministrit.

Me porosi të kryetarit ose nënkryetarit të Komisionit, Sekretariati ka detyrimin të njoftojë anëtarët e Komisionit për vendin, datën, orën dhe axhendën e mbledhjes.

6. Mbi bazën e vlerësimit nga anëtarët e komisionit, si dhe duke pasur në konsideratë edhe opinionin nga institucionet e tjera ose ekspertë të fushës, Komisioni i propozon titullarit të institucionit:

- i) pranimin e kërkesës;
- ii) refuzim të kërkesës, duke paraqitur dhe argumentet përkatëse, për shkaqet e refuzimit.

Titullari i institucionit, pasi shqyrton propo-zimin e Komisionit, shprehet me urdhër për miratimin ose jo të kërkesës.

Për projekte specifike që kërkojnë njohuri teknike të veçanta, Komisioni mund të kërkojë njohuri teknike të veçanta, Komisioni mund të kërkojë mendim nga institucionet e varësisë, apo drejtorive

brenda ministrisë.

Komisioni mund të kërkojë informacione shtesë, nga subjekti aplikues për leje nëpërmjet AZHT-së apo pushtetit vendor.

7. Komisioni shqyrton edhe kërkesat lidhur me ndryshimin e kategorisë së tokës (bonitetit) për qëllime ndërtimi, në përputhje me fushën e përgjegjësisë së ministrisë. Vetëm pas shqyrtimit dhe miratimit paraprak të projektpropozimit, Komisioni, nëpërmjet Sekretariatit Teknik, i drejtohet ministrisë përgjegjëse për tokat bujqësore, lidhur me konvertimin e kategorisë së tokës.

Në rast miratimi paraprak të ministrisë përgjegjëse për bujqësinë, Komisioni në bashkëpunim me drejtorinë juridike dhe drejtoritë që mbulojnë fushën përkatëse, ka detyrimin për hartim të projektvendimit përkatës, për ndryshimin e kategorisë së tokës dhe dërgimin për miratim në Këshillin e Ministrave. Pas miratimit nga Këshilli i Ministrisë i vendimit të Këshillit të Ministrave për konvertimin e kategorisë së tokës, subjekti vijon me aplikimin për leje, sipas legjislacionit në fuqi.

8. Propozimi i Komisionit për lejet që mira-tohen nga KKT-ja, i njoftohet ministrit, i cili vendos për pranimin ose jo të propozimit. Vendimi i marrë nga ministri mbi projektpropozimet/ kërkesën për leje, në përputhje me strategjitë dhe politikat e MZHETTS-së, përgatitet përgjigjja zyrtare, në emër të institucionit.

Për çështjet që lidhen me pushtetin vendor, lidhur me kontrollin e konformitetit të projektpropozimit ose çështje të tjera, që nuk kalojnë për miratim nga KKT-ja, pasi shqyrtohen nga Komisioni dhe merret një vendim, nuk kanë nevojë të miratohen nga ministri, por kthehet përgjigje nga MZHETTS-ja me shkresë, e cila firmoset nga kryetari/sekretari i përgjithshëm.

Dërgimi i vendimeve të Komisionit, dokumen-tacioni dhe komunikimet mes AZHT-së dhe MZHETTS, bëhet nëpërmjet Sekretariatit Teknik të Komisionit vetëm në rrugë elektronike, nëpërmjet sistemit *online*.

Për komunikimet me pushtetin vendor dhe institucionet e tjera, apo subjekte kërkuuese komunikimi bëhet me shkresë zyrtare, nëpërmjet zyrës së protokollit.

9. Për kërkesat që lidhen me lejet, Komisioni shqyrton kërkesën brenda 5 ditëve, nga paraqitja e kërkesës nga AZHT-ja ose AKPT-ja dhe kthen përgjigje zyrtare brenda 10 ditëve nga dërgimi i kërkesës, nëpërmjet autoritetit përgjegjës të planifikimit. Në mungesë të përgjigjes brenda afatit 10-ditor, pëlqimi/miratimi quhet i dhënë, sipas parimit të miratimit në heshtje dhe autoriteti i planifikimit ka detyrimin të vijojë, me shqyrtimin e kërkesës për leje.

Për kërkesa të tjera, të cilat nuk përcillen nëpërmjet sistemit *online*, Komisioni shqyrton kërkesën dhe kthen përgjigje brenda 30 ditëve, nga paraqitja e kërkesës në MZHETTS.

10. Njoftimi i vendimeve të komisionit, doku-mentacionit dhe komunikimet mes autoriteteve përgjegjëse të planifikimit dhe institucioneve të tjera, bëhet nëpërmjet Sekretariatit të Komisionit, në mënyrë elektronike ose shkresore.

11. Sekretariati ka përgjegjësi, për:

a) Njoftimin e kryetarit të Komisionit lidhur me kërkesat dhe çështjet për leje, që paraqiten për shqyrtim nëpërmjet sistemit elektronik, nga autoritetet e planifikimit të territorit ose institucione të tjera shtetërore apo subjektet private.

b) Bashkëpunimin dhe koordinimin e punës me drejtoritë brenda ministrisë ose institucionet dhe agjencitë e varësisë, lidhur me sigurimin e informa-cionit të nevojshëm, në funksion të lejes së ndërtimit dhe kthimin e përgjigjes subjektit të interesuar.

c) Në varësi të kërkesës, Sekretariati nëpërmjet institucioneve të varësisë mund të bëjë të mundur edhe sigurimin e autorizimeve apo lejeve të nevojshme, në funksion të lejeve të ndërtimit, duke respektuar legjislacionin përkatës.

d) Njoftimin e palëve të interesuara lidhur me vendimin e Komisionit për lejet e ndërtimit apo çështje dhe problematika që shqyrtohen nga Komisioni pranë MZHETTS-së, sipas fushave të përgjegjësisë shtetërore të ministrisë;

e) Përgatitjen e draftformularit të lejes së ndërtimit, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e marrjes së njoftimit nga AZHT-ja, për lejet të cilat është marrë vendim nga KKT-ja. Sekretariati përgatit/pasqyron në draftformularin e lejes së ndërtimit, vetëm treguesit e zhvillimit dhe të dhënat teknike të ndërtimit të pasqyruara në vendimin e KKT-së dhe dokumentacionit shoqërues që i bashkëlidhen këtij vendimi, draftformulari, verifi-kohet paraprakisht dhe miratohet nga Kryetari i Komisionit të Vlerësimit ose nënkryetari dhe përcillet në AZHT me qëllim vijimin e proce-durave, sipas legjislacionit për lejet e ndërtimit.

13. Për ndjekjen e këtij udhëzimi ngarkohen sekretari i përgjithshëm i MZHE'TTS-së, në cilësinë e kryetarit të Komisionit të Vlerësimit, Komisioni dhe Sekretariati.

14. Udhëzimi nr. 217, datë 28.3.2014, shfuqi-zohet.

15. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ZHVILLIMIT EKONOMIK, TURIZMIT, TREGTISË DHE SIPËRMARRJES

Milva Ekonomi